


Zenun Çelaj

Gazetar dhe redaktor

Unë jom Zenun Çelaj i lindun në fshatin Vuthaj, në Mal të Zi, është Lugina e Plavës dhe e Gusisë, një rajon historikisht shumë i njoftun. Kështu fatkeqësisht është shkëputë prej trungut të Shqipërisë edhe Kosovës, ka mbetë mjaft e izolome. Njerëzit janë shpërngulë kryesisht në Amerikë dhe në Kosovë. Një familje blegtorale shumë e madhe, e ndame, një pjesë, pjesa ma e madhe pat mbetë në Shqipëri kur u ndanë atëherë Jugosllavia me Shqipërinë. Fjala është për '48-shin. Një pjesë kanë ardhë në Kosovë, po ka që kan ikë edhe në Shqipëri.

Unë, me pak shokë vazhduem shkollimin, funksiononte një shkollë shqipe po me... fillorja ish complete me dyqind e sa nxënës në fshat, kurse tetë-vjeçarja ishte në Gusi, nja pesë kilometra larg Vuthajve ku gravitonin banorë, nxanës edhe të disa fshatrave të tjera që ishin me popullatë shqiptare: Martinaj, Kukaj, Vishnjevë, Hot, Gërnqarë. Aty megjithatë ishim një numër shumë i kufizuem në tetë-vjeçare, në fund mbetem tetë vetë, ishin dy femra e na të tjerët gjashtë. E kryem tetë-vjeçaren aty në Gusi dhe vazhduem kryesisht në Kosovë. Unë vazhdova në Pejë, se ideali i secilit prej nesh ishte me u ba mësues se s'kishe mundësi tjetër prosperimi pos mësues të bahesh. Edhe fillova, shkolla Normale ishte në Pejë mirëpo atëhere regjimi serb e mbylli shkollën Normale në Pejë tha, "Mund të shkoni në Gjakovë, Prizren ose në Prishtinë", edhe na që ishim në Pejë vazhduem në Gjakovë. Pastaj prap edhe në Gjakovë e mbyllën, se kishin frikë se po shqiptarizohemi shumë, se aty veç shqip flitej e këndohej, kangët e "Radio Tiranës" edhe e mbyllën shkollën normale edhe aty. Thanë, "Mund të shkoni në Prizren ose në Prishtinë". Unë vazhdova natyrisht në Prizren me një shumicë shokësh, po aty pata një konflikt me një profesoreshë të gjuhës serbe. Ishte faji jem kryesisht se u shpreha keq për serbët, natyrisht edhe ma zbritën sjelljen, atëherë s'kishte njësha po dysha. Në gjysëm vjetor m'u banë prej nxanësit të shkëlqyeshëm pesë-gjashtë dysha, ishte si me thanë ishin kriju kushtet me përsëritë klasën. Atëherë gjeta lidhje në Prishtinë, në Normale të Prishtinës, ka qenë Rexhep Qosja, ja keni nje zanin sigurisht, bashkë-fshatar, ish... profesor ishte Hasan Mekuli, e luta të bisedojë me Hasanin që t'më pranojnë në Prishtinë. Erdha, edhe e kreu Normalen, pastaj menjëherë pak pa diplomue, Rilindja që deri atëhere kishte punu me një numër të kufizuem gazetarësh ishin dikun pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë, Rilindja prej një gazete me dhjetë, dymbëdhjetë faqe, tetë faqe, dilte dy herë, tri herë në javë. Filloi një kohë përpara të jetë e përditëshme, pos të dieleve nuk dilte. Erdhën konkursi, unë... m'u tek me konkurue se nuk mendojsha se kom ndoni talent për gazetari, megjithëse hartimet e këto i bëja mirë, po konkurova megjithatë edhe më pranuan, mbas asnjë muaji më erdh lajmi, "Je i pranuem". Unë nuk njihesha as me njerëzit e Rilindjes, me gazetarë, ishte vetëm një koleg që... ai nuk ishte gazetarë ishte gjimnazist, Nehat Islami, po ishim si një brez, ai në gjimnaz unë në normale, shoqëroheshim, edhe ai nguli kambë të, "Shkojsh gjithësesi gazetar, të shkojmë bashkë". Ai e njihte, nja dy prej redaktorëve i nihte mirë se redaktonte faqen e fëmijëve. Edhe shkova, mbeta, ishin tre muaj kanë qenë muaj provë në atë kohë, e kalova atë provën me sukses edhe, mbeta [qeshë].



Gjatë punës raportuese në Korenë e Veriut

Në foto: Zenun Çelaj

Nga arkivi personal i Zenun Çelaj

Po ishte fillimi, fillimi viti i parë që... se Rilindja e ka pasë si praktikë, tre muaj nuk të ka botua kurgja hiç, mbas tre muajve ndoni ngjarje, kështu lajm të vogël ka lejue. E tash unë duket se shquhesha me shkrime e në ato fillime më thonë, “Me shku me përcjellë qët mbledhje të lidhjes”, jo, lidhja e kooperative a çka ka qenë, po. Shkova e përcolla, asgja nuk kuptojsha. Ata flitshin, “kooperimi”, çka po di unë, “agroteknika, agromasat” edhe unë shëno, shëno, një bllok e mbusha plot. U ktheva në redaksi. Një Hasan Myrtezai ka qenë, një redaktor shumë petagog i mirë, tha, “Hë çuni”, se kështu e ka pasë, tha, “A ja nise, a po shkruen?” thash, “Për fat t’keq unë asgja nuk kom kuptue”, “Si more ashtu?” I thash, “S’i marrsha vesh, s’disha çka po thonë.” Ai e thirri një gazetar sërb të radios n’atë kohë, Stoianoviç, i tha “A bon me ma dërgue shkrimin”, se më pyeti, “Kush ka qenë prej redaksive të tjera?” Thash, “Radio Prishtina, *Jedinstvo*, edhe na”, edhe ai e dërgoi, e m’tha, “Merre lexoje”, serbishten e kam ditë natyrisht.

Po kish qenë aq e thjeshtë sa unë u ula e shkrova, natyrisht [qeshë]. Mandej kam pasë gjithnji kujdes që mos me shkue dikund i pa përgatitun.

Kemi qenë redaksi, gazetarë në ato vite edhe më vonë, shquhet Rilindja për punë me përkushtim shumë të madh. Ne gazetarët, mua më ka ndodhë, në ato fillime një lajm shtatë-tetë rrjeshtash, ka ndodhë edhe pesëmbëdhjetë herë me e shkruar. Atëherë s'ka pasë kompjuter po maqinë të shkrimit. E shkrujsha, e lexo, ndërhy, redakto, një herë e dy, e tri, e katër, me e çue ashtu me shënime me dorë, s'mbërrishin shtypëshkronjat me e dëshifruar. Po du me thanë, kjo ka qenë ajo përvoja e fillimit që ka vazhdu vazhdimisht, gjithmonë domethanë, me përkushtim, me përpjekje shumë të mëdha, me kujdes me, dhe jo veç unë, por edhe kolegët e tjerë. Te Muzeu i Kosovës, ka qenë burg dikur, tash në kohën kur shkova unë ishte Rilindja edhe aty si me thanë më caktuan me punë, i thojshim "Rubrika e Brendshme", edhe deri sa u mbyll gazeta i kanë thanë, "Rubrika e Brendshme", se është marrë me probleme të brendshme, e jo të politikës së jashtme. Edhe aty u dallova më duket tri-katër vjet, dhe më avancuan në redaktor. Atëherë udhëheq'sha grupin e gazetarëve të ri dhe natyrisht shkrujsha. Tashmë kishin kaluar tri-katër vjet dhe praktikisht fillova me u familjarizuar edhe me profesionin edhe me gazetarët, me kolegët tjerë. Fillova, mos t'gënjej, me e dashtë verbnisht profesionin. Edhe ashtu merresha me shkrime, kryesisht me shkrime të lira. Një kohë e kam përcjellë Organizatën e Rinisë me që isha shumë i ri, nëntëmbëdhjetë vjeç pata filluar punën. Vazhdova domethanë të merrem me këtë, si me thanë, me problemet edhe të rinisë dhe të gazetarisë, edhe ta dua me themel, edhe mbeta deri katërdhjetë vjet praktikisht.



Në foto: nga e majta në të djathtë, Zenun Çelaj, Ali Sutaj, Rexhai Surroi
Nga arkivi personal i Zenun Çelaj

Tash në Rilindje në atë kohë nuk kishte maqina shkrimi të mjaftueshme, ishim krejt Rubrika e Brendshme, si me thanë pesë-gjashtëmbëdhjetë vetë, e kishim dy makina shrimi 'Olivetti' ishin makina italiane. Edhe më caktuan me shku me përcjellë një ngjarje, por po kthehem, ajo në gazetari është e përditshme, të njëkë koha, duhesh shpejtë me i krye se edhe mbyllet gazeta edhe s'ka, s'të pret. E tash unë lypsha makinë shkrimi, e s'gjeta, e hina në njërën prej zyreve ky, Albert Dushi, po atëhere jo veç për Albertin po ka qenë gati rregull, ti kudo ke hy në zyrë në Prishtinë, në Kosovë, ki folë serbisht mas pari, se normalisht kanë qenë kryesisht serb përgjegjësit ose njerëzit që kanë punue aty. E tash unë me këtë bindje, me këtë shprehi edhe në Rilindje masi fillova, po hy unë po i pyes ata, ish ulë prej një tavoline kështu të punës, me musteqe, burrë i hijeshëm kështu, edhe po i thom serbisht "*Im pisaće mašine ovde?*"¹ ai tha, "*Nema*" - "Jo s'ka. Po çka po të duhet?", thash, "Me shkru" unë në serbisht gjithënjë, po tha, "Në çfarë gjuhe?", "Shqip", "Ani, pse s'flet shqip?". Edhe [*ofshanë pastaj qeshë*] më erdhi marre. Ai ishte gazetar i sportit, po vjen koha ai të jetë daja i gruas sime [*qeshë*] ma vonë [*qeshë*].

Atëhere, verës sidomos, ishte krizë për lajme, e gazeta duhej me u mbushë faqet, edhe më caktuan mua "Kqyr a po ndodh naj fatkeqësi a diçka...". Edhe une kqyr provo andej s'ka, asgja s'ndodhte, shkova n'atëkohë se duhej me pyt policinë, nuk ka, qetësi, edhe hajt thash po shkoj po lahem. Bazeni ka qenë te Medresja e re tash, në atë luginën s'di a po e dini ku i bjen. Shkova atje edhe në këtë anën knej, në njërën anë, në anën tjetër ishte Abdyl Bunjaku një

¹ Përkthimi në shqip: "A ka maqinë shkrimi këtu?"

karikaturist, ai punonte në gazetën “Zëri”, edhe dikur erdh “Çka po bën këtu Zenun?” thash, “Po kqyri valla ngjarje s’po ka, mos po mbytet dikush, ta kom lajmin”. U ba si me thanë mahi, u qesh. Kur, se të dielen dilte faqja e humorit në Rilindje... kur ai e kishte vizatue një njeri buzë bazenit edhe po pyet “Zenun”, bash me emër [qeshë] të njejtat fjalë, “Çka po bën?” - “Qe po pres mos po mbytet kush se s’kam ngjarje”. Krijohej humor, ishim pak vetë edhe kryesishit kemi kalu jashtëzakonisht mirë, kolegë shumë të mirë. Më ka ndodh, s’e di a e kam aty a jo,² si redaktor i rubrikës, i politikës me fjalë të tjera, ky Nehat Islami për herë të parë fitoi si me thanë mundësinë me shku me e përcjellë ngjarje në Israel. Edhe ai fluturoi deri në Itali, e paralajmëruam një ditë përpara ngjarjen “Do të kemi tash përditë raportet e Nehat Islamit”. Edhe ai shkon në Romë po nuk fluturon aeroplani, ngjarjen e kishim paralajmërue “Qysh me i’a ba?”. Atëherë shikova unë agjensitë e tjera çka kanë shkruar për Israelin atë ditë, çka ka ndodhë, çfarë zhvillimesh ka pasë, e në emër të Nehat Islamit e shkrova [qeshë]. Na e njifshim njëri-tjetrin, i’a njifshim edhe stilin edhe shprehjet domethanë, kështu që njerëzit edhe s’e kanë dallue se nuk e ka shkruar ai.

Po u ba e ditun se një person në Pejë e ka ndrrue gjininë, edhe haptas nuk po i vjen as marre as kurgja. Unë shkova tash e bana bisedë të gjatë kam pasë ba n’vazhdime, në disa vazhdime, ka qenë në Rilindje, edhe ai e pranonte këtë, po unë natyrisht as nuk e fyeva, as nuk e shava, po veç e përshekrova, ndonihërë dilte si lavdatë e tij, si thirrje edhe të tjerët të bajnë çka të donë [qeshë]. Edhe qikjo ka qenë ajo një... kolegët edhe më shanë, më kritikuen, se ishte për herë të parë dikush me shkru ose m’u shkru në gazetë për një person të kësaj natyre, të këtij lloji. Unë e shkrova, ishte lexue jashtëzakonisht shumë, këta më thirrshin edhe me telefon e krejt, disa më shajshin disa më lëvdojshin edhe kështu, kaloi.

Na në Kosovë kem fillue në ‘68-shin, u majt një, kish dalë projekti i gjuhës standarde, me debatue ekspertët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, megjithëse atje kanë qenë ma të kufizuem. U mbajt në Fakultetin Filozofik, në një sallë, u mbajt konsultë, edhe ashtu quhet “Konsulta e gjuhës shqipe” në ‘68-shin edhe u vendos, u morrëm vesh me fillue menjëherë gjuhën standarde. Edhe e njejtë është ajo e ‘72-shit se ajo s’pati ndryshime të mëdha, ishte e njejtë. E na nuk e kemi pas të vështirë kryesisht, një kategori se edhe në studime në fakultet kemi msue me njëk edhe gjuhën standarde edhe këtë gjuhën natyrisht, ajo nuk ka qenë krejt klasike geqe me thanë, ajo që e shkruanim deri atëherë, por ka qenë shumë ma afër standardit. Ka mungue kjo “uer” e pa za, që e kemi pasë ma vonë me standard shumë ma të shpeshtë, se ndryshe praktikisht e njejtë ka qenë.

Na kemi pasë një praktikë në gazetë, mbanim mbledhje çdo të hane edhe analizatori duhej ti detektonte gjithënjë këto gabimet gjuhësore, devijimet në gjuhën, kur filloi gjuha standarde kështu. Në gjuhën standarde domethanë merreshin edhe masa edhe ndëshkime, ka pasë dënime atëhere, tash s’ka, me pare. Tash se na kem pasë me poena i thojshim, pika në gazetari, evidencat vishin në do farë formularë, çka po di unë, edhe aty ti hiqte 10%, 6%, 5, që ishin pare, mundeshin 10 dinarë, 20, po atëherë dinari ka qenë shumë më i madh.

² Iu referohet librit autobiografik të tij “Udhëtime në të shkruarën”, mbi të cilin është bazuar një pjesë e intervistës

Objekti i vjetër te muzeu, ai ka qenë një objekt i vjetër, ish burg, natyrisht i adaptuëm, pak zyre ka pasë. Na punojshim dhjetë-pesëmbëdhjetë, njëzet dikur vetë, kur u rritëm, se '87-shin, [mendohej] po ashtu po i bjen, kaluem na në ojektin e ri. E duhej, s'kishe as ku mu ulë, as karriga s'ka pasë, tregova se maqina shkrimi nuk kishte, ishin dy-tri duhej me pritë në rend për me e marr maqinën, me pasë ku me shkruë si me thanë, çka, si me shkruë. E mandej [konfuzohej] a në '87-shin, qe m'u kanë ngatrrue, '77-shin, e ma heret filloi ndërtimi i Pallatit të Shtypit, filluen investime për kulturën, për informimin shqiptar, ndër të tjera edhe Pallati i Shtypit. Në '77-shin u krijuen hapsina ku mund të shkojmë një pjesë e redaksisë edhe shumë, nuk zgjati shumë, shkuen të gjithë të tjerët. N'kët ndërtesën e vjetër, thash ishim shumë vetë natyrisht se duhej me diciplinë, mrena mos me ba zhurmë, mos me i pengue tjetrin. E kishte edhe të mirën e vet se konsultoheshim mes veti "Qysh me e shkruë këtë fjalë, e këtë mendim e, me trajtue problemin". Ndërkohë u ba kjo me kalue në Pallatin e Shtypit. E atje i kem pasë të ndame pjesët. Praktikisht ishin kah dy-tre simbas sektorit, tavolina të veçanta natyrisht edhe me ksi, separe. Duhej me fol të vogël për shkak se ajo nihej gjith'kund shkonte (zëri) se hapësina e ndërtesës e naltë edhe mrenda dhomat kanë qenë, një kat për shembull na e kemi pasë kati i pestë, ajo njëqind e pesëdhjetë metra m'duket njëri krah, dyqind e pesëdhjetë tjetri. Nejse, në mes kanë qenë liftat edhe VC-të, çka po di unë. Në një kënd ka qenë një byfe e vogël, aty domethanë njiheshim shumë njani-tjetrin, ka plot vica edhe banal, qishtu njerëzit t'u mos ditë ose t'u e ditë se po nihet krejt.

Tham edhe tash, megjthëse kanë vdek, janë rrallue njerzit, thojshin "Të mbajmë në mend posaqërisht ka pesë-gjashtë paqeta cigare në tavolinë" edhe natyrisht ajo taketukja plot, grumbull me duqa të cigareve, se sot më vjen me vjellë [qeshë].

<<< *Pirja e duhanit në zyret e maqinave të shkrimit* >>>

Puna ka qenë numër një, pa krye punët, detyrat, ti s'ke mujtë as me shkue n'byfe as me u ul, se edhe filluen me lujtë letra një kënd aty. Mu m'pengonte si redaktor, edhe po i thom Maksut Shehut, ka qenë kryeredaktor thash, "Osht ka m'pengon" thash, "qysh po lun letra, aty deri në gjysë të natës e pas gjysës së natës e" tha, "Shuj se shumë mirë osht, kur t'na duhen njerëzit veç i thue Beqir shko në këtë detyrë, ti knej, edhe ai s'ka qare pa i Ishue meniher edhe lojën e krejt e me shkue" [qeshë]. Po du me thanë, puna ka qenë mbi t'gjitha, puna mbi t'gjitha. Atmosfera ka qenë shumë njerëzore me thanë t'drejtën. E mandej s'ke pasë kohë me u marr me gjana të parëndësishme në jetë kështu, po me gjana të randësishme. Na sot flasim "Jo kështu bani Albini, jo bani ai tjetri, ky s'po ja qëllon, ky po rren, ky po vjedhë, ky po mashtron". E atëhere nuk ka pasë kohë për kso gjanash, u dashtë si me thanë me qenë i përqëndruem në punë.

Kjo të merr malli, edhe debatet si i kemi zhvillue, shpesh ndonihere edhe tash pra, po nuk ka pas idhnim mes veti. Interesant, e ke kritikue tjetrin, "E ke shkruë keq këta, kjo fjali është dashtë të jetë kështu" edhe kjo ka qenë praktikisht një lloj shkolle për gazetarët edhe sidomos edhe të ritë që të mësojnë, t'bahen ma të kujdesshëm.

Mos gabofsha në '93-shin ishin, filloi Sërbia praktikisht e suprimoi autonominë e Kosovës. I mori të drejtat në shumë fusha, ndër të tjera edhe në, për gazetatat që ishin Rilindja, në atë kohë

“Jedinstvo”, “Fjala” [mendohef]... nuk kanë qenë shumë, po ishin të pavaruna, e, edhe Rilindja natyrisht e kish emrin, ishte një ndërmarrje me një numër dy-tre mijë puntorë i ka pasë. Ata tash masi e murrën autonominë, filluen me i ndrrue edhe me i caktue edhe eprorët, drejtorët e ndërmarrjeve. Atyne ndërmarrjeve po që edhe i’a u ndrronin emrin, ndër të tjera Rilindjes... Rilindjen si shtëpi kështu i’a ndrruen emrin, e quajtën “Panorama”. Na nuk e pranuan në Rilindje këtë ndryshim. Filloi ajo rezistenca që përfundoi praktikisht me luftën e UÇK-së. Po na këtë rezistencën e bojshim me veprime. Edhe këso-dore si me thanë, e kundërshtuem, po ata megjithatë e prunë drejtor sërb, një drejtor që duhej me na komandu, na s’e përfillshim, edhe filluem na këtë grevën e urisë me Adem Demaçin në krye.

<<< Nga greva e urisë së gazetarëve në Rilindje, 31 Maj 1993;

Flet, Behlul Jashari:

“...po asnjëri nga punëtorët e Rilindjes nuk ka shkuar për bajram në shpi. Nuk ndijnë atmosferë feste. Të gjithë jemi në pritje të madhe se ‘Çka do të ndodhë sot, çka do të ndodhë nesër?’. Ekziston një rrezik i madh që këto të jenë orët e fundit, ditët e fundit të qëndrimit të shqiptarve në kullën e vet, në kullën e Rilindjes.

Grevistët e urisë ngujuar që tetë ditë këtu në Pallatin e Shtypit të vetmin kontakt me jashtë-pallatin e kanë shikimin në botë nga këto dritare.

Ata janë ngujuar që tetë ditë këtu dhe janë barrikaduar në mbrojtje të fjalës së lirë shqipe” >>>

Ademi ishte në krye të “Fjalës” ka qenë gazeta “Fjala”, ai ishte në krye të asaj edhe ai tha “Unë jom ka hy në grevë ju boni çka të doni” edhe na u bamë ndoshta njëzet-tridhjetë vetë, se jo t’gjithë, nuk hyn në grevë. Edhe në Rilindje morrëm plafë, ndoni dyshek kështu, dhe vazhduem për tetë ditë, nëntë ditë ashtu. Po tash kishte ndoni spekulant që edhe hante, se na kishim në grevë urie, po une me thanë të drejtën nuk kam hangër. E kam, taman kam vujtë urinë. Ai, Ademi, se vishin, këta të, në atë kohë, Lidhja Demokratike ka ekzistue edhe Këshilli i të Drejtave të Njeriut, aty isha une sekretar në këshill, e filluan me ardh me na vizitu. U ba puna e madhe ‘Greva e urisë e gazetarëve’ e dikur Ademi thotë “Po e ndërpreme se nuk ka këtu punë, po na s’po e ndërrojmë emrin e Rilindjes”. E vazhdum me Rilindje, megjithatë na nalën, e ndalunë, pat’ hy policia në shtypshkronjë në Rilindje. E nali gazetën edhe na mas pak ditësh vazhduem prap, prap e ndalën. E tash ishin disa gazeta të tjera “Bujku” ndër të tjera, gazetë për bujqit [qeshë], ishte me leje nuk kishte vendim të qeverisë të Sebisë për me e ndalue. Edhe na tham dalim me emër “Bujku” e përmbajtja osht’ Rilindja. Edhe ashtu e vazhduem deri në fund, praktikisht deri në prill, jo në prill po në mars të ‘99-shit, kur filluen bombardimet me 23 dikun ashtu i bjen të prillit. Na vazhduem me dalë, po na qitën prej ndërtesës Pallatit të Shtypit edhe të Rilindjes. Dulëm na nëpër shtëpia qishte herë te dikush, edhe këtu³ është përgatitë ndoni numër, po përgatitë, e nxjerrnim qashtu si “Bujku”, mandej filluem si Rilindje pak para se me fillu bombardimet. Mandej filluen bombardimet edhe ma u ndal gazeta praktikisht deri mas luftës.

³ Në shtëpinë e Zenun Çelaj